

Arbresha Dina, MA<sup>1</sup>

UDC:

334.722:657(497.115)

334.722:657.37(497.115)

**MJEDISI BIZNESOR DHE RËNDËSIA E KONTABILITETIT DHE  
RAPORTIMIT FINANCIAR NË KOSOVË**

**БИЗНИС СРЕДИНАТА И ВАЖНОСТА НА  
СМЕТКОВОДСТВОТО И НА ФИНАНСИСКИОТ ИЗВЕШТАЈ  
ВО КОСОВО**

**THE BUSINESS ENVIRONMENT AND THE IMPORTANCE OF  
ACCOUNTING AND FINANCIAL REPORTING IN KOSOVO**

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Radoniqi” SH.A., Gjakovë

**Abstract**

The economic system of every country including Kosovo could function normally and without much trouble if the direction of each unit economic takes overall a correct and fast information. Among the many information that uses the direction of each unit economic, accounting plays a special role. The definitions of accounting have changed and evolved at different times. Accounting developments are related with the developments that the society had overall. This development is expressed in the role that accounting plays, in the life of economic unit and the ways and means of processing the economic information and financials related to them. Financial accounting has intention to develop knowledge and skills understanding about the principles, concepts and regulations that dealing with financial accounting. Comprehensive accounting services are designed to reduce complexity and are able to

---

<sup>1</sup> Master of Economic Sciences, Finance and Accounting, University of “Hasan Prishtina”- in Prishtinë, e-mail: [arbresha\\_dina@hotmail.com](mailto:arbresha_dina@hotmail.com)

address the specific needs of each business entity. Accounting is a function of every economic unit that operates in different areas. Standard Practices of accounting require companies that trade publicly to follow some rules of accounting when presenting the financial statements so that the readers of the statements can compare easily with different companies. Private companies are also often asked by banks and shareholders to represent the information in accordance with their specific rules. Financial Reports for General Purposes provide related information about financial position of a reporting economic unit, which information is related to the entity's economic resources and additional requirements to the reporting entity. So the importance of accounting contemporary does not only stand in the fact that it fills the means of presenting the financial data, but also the conditions that creates for the necessary information for the final results and helpful that gives the state the most effective use of its resources solving the problems facing the financial field.

Key words: Business Environment, Accounting, Financial Reporting, Human Resources

### **Hyrje**

Biznesi është një nocion i përgjithshëm i aplikuar për veprimtaritë e përfshira në prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve. Kontabiliteti përdoret për të regjistruar dhe raportuar efektet financiare të veprimtarive të biznesit. Për këtë arsye, kontabiliteti quhet ‘gjuhë e biznesit’. Ai ofron kuptimin e të regjistruarit dhe komunikimin e suksesit apo dështimit të organizatës biznesore.<sup>2</sup> Shumë njerëz në jetën e përditshme kontabilitetin e kuptojnë si një llogarimbajtje. Llogarimbajtja (book keeping) është një pjesë e procesit të kontabilitetit që ka të bëjë vetëm me regjistrimin e transaksioneve në librat e kontabilitetit. Për këtë fushë nuk kërkohet njohuri e avancuar paraprake sepse llogarimbajtësit nuk merren me krijimin, analizën dhe interpretimin e informacionit kontabël. Ndryshe nga kjo, kontabiliteti është proces i identifikimit, regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të informacionit ekonomik për marrjen e vendimeve.<sup>3</sup> Kontabiliteti dhe informacioni kontabël është i rëndësishëm për drejtimin e njësive ekonomike në veçanti dhe shoqërisë në tërësi. Informacioni në drejtimin e një sistemi ekonomik në tërësi ka një rol të madh për të siguruar kushtet që të gjithë

---

<sup>2</sup> Skender Ahmeti: Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2012, f. 34.

<sup>3</sup> Rustem Asllanaj: Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2010, f. 23.

operatorët e tij të kenë mundësi të orientohen dhe të marrin vendimet e duhura. Kështu sistemi ekonomik do të mund të funksionojë normalisht dhe pa probleme. Informacioni kontabël ka rëndësi mjaft të madhe në procesin e vendimmarrjes, për përmirësimin e drejtimit, organizimit dhe administrimit të njësisë ekonomike.<sup>4</sup>

### **Njohuritë e Përgjithshme mbi Mjedisin e Biznesit**

Biznesi është një mënyrë organizimi e aktivitetit me qëllim të sigurimit të fitimit për të furnizuar njerëzit me mallra dhe shërbimet që ata kanë nevojë. Format e organizimit të biznesit për realizimin e qëllimeve të tij janë të ndryshme. Krijimi i mundësive për themelimin e rregullt të bizneseve fitimprurëse, caktimi i pronësisë, përgjegjësia dhe kompetencat për vendimmarrjen lidhur me to, mënyrat, mjetet dhe procedurat për organizimin, strukturën dhe administrimin e këtyre bizneseve, janë orientimet kryesore të secilit që merr një iniciativë për fillimin e aktivitetit. Janë tri lloje të organizimit të bizneseve:

**1. Bizneset shërbyese** kryejnë shërbime për një tarifë. Ky grup përfshin firmat e kontabilitetit, firmat për shërbime juridike, firmat për shërbime shëndetësore, firmat e pastrimit etj. Të gjitha këto, aktivitetet final e kanë shitjen e shërbimeve për palë të ndryshme të interesuara.

**2. Bizneset tregtare** blejnë mallra që janë të gatshme për shitje konsumatorëve. Të tilla janë: kompanitë e shitjes së mallrave ushqimore, tekstilit, këpucëve, veturave etj.

**3. Bizneset prodhuese** të cilat inputet e tyre materialin direkt, punën direkte dhe kostot indirekte të prodhimit, përmes procesit të prodhimit, i transformojnë në produkte të gatshme, të cilat pastaj i'a shesin bizneseve të ndryshme tregtare me shumicë dhe pakicë.

Kontabilistët shpesh iu referohen organizatave biznesore si një entitet kontabël apo si entitet biznesi. Një entitet biznesi është një organizatë biznesi, që për qëllime të kontabilitetit, secila nga këto ka një ekzistencë të ndarë nga pronarët e saj, kreditorët, të punësuarit, konsumatorët dhe nga bizneset tjera. Ky koncept aplikohet te tri forma të bizneseve, të cilat për qëllime të kontabilitetit janë të ndara nga entitetet tjera biznesore, por edhe nga pronarët e tyre. Për dallim nga organizatat jofitimprurëse (siç janë shkollat, qeveria etj.), qëllimi primar i të cilave është ofrimi i shërbimeve në mënyrë efektive dhe efeciente, entitetet biznesore kanë për objektiv kryesor krijimin e fitimit për pronarët e

<sup>4</sup>Agim Binaj & Flutura Kalemi: Kontabiliteti, Tiranë, 2006, f. 13.

tyre. Të tilla entitete biznesore janë: 1. Bizneset individuale apo bizneset me një pronar; 2. Ortakëritë dhe 3. Korporatat.<sup>5</sup>

**Bizneset inokose** janë në pronësi të një individi. Pronari i biznesit mund të jetë menaxher dhe punëtor i biznesit. Kontabiliteti i këtyre firmave duhet të jetë plotësisht i veçantë nga pasuria personale e tij. Në aspektin ligjor këto biznese janë me përgjegjësi të pakufizuar që do të thotë në qoftë se falimenton biznesi, në përmbushjen e detyrimeve ndaj të tretëve, krahas pasurisë së firmës duhet të përdoret edhe pasuria e tij personale.

**Bizneset partnere** janë në pronësi të dy ose më shumë pronarëve individualë. Këto krijohen mbi bazën e një marrëveshjeje gojore ose me shkrim dhe në këtë rast investimet e tyre të veçanta, mbahen ndaras në totalin e kapitalit, në bazë të shumave të investuara, me fjalë tjera në bilancin e firmës, kapitali i secilit pronar prezantohet në mënyrë të veçantë. Kontabiliteti i bizneseve partnere mbahet ndaras nga pasuritë personale të tyre. Bizneset partnere janë me përgjegjësi të pakufizuar, por nuk do të thotë se të gjithë partnerët të jenë në përgjegjësi të pakufizuar.

**Korporatat** janë entitete legale të krijuara mbi bazën e ligjeve të veçanta të shoqërive aksionare të çdo shteti. Pronësia në korporatë krijohet mbi bazën e shpërndarjes dhe transferimit të aksioneve të rregullta, të cilat shiten në tregjet e kapitaleve. Emetimi i aksioneve të rregullta nga korporata i sigurojnë asaj kapitalin aksionar. Totalin e kapitalit aksionar të korporatës e përbëjnë: aksionet e rregullta, aksionet preferenciale, fitimi i mbajtur dhe premia në aksione.<sup>6</sup>

Forca të ndryshme të mjedisit mund të jenë më pak apo më shumë të rëndësishme për organizatën. Forcat kryesore të mjedisit mund të ndryshojnë nga një organizatë në tjetrën. Ekspertët e drejtimit kanë argumentuar se shkaku më i rëndësishëm i ndryshimit të mjedisit të biznesit është ndryshimi në strukturën dhe dinamikën e popullsisë. Ky fenomen shkakton ndryshime në mjedisin social, ekonomik dhe politik të një firme apo edhe të një kombi. Në rast se një popullsi në rritje ka një fuqi blerëse të mjaftueshme, për të kënaqur nevojat e saj duhen krijuar tregje të reja. Ndërsa, rritja e popullsisë në një vend me burime natyrore të kufizuara, mund të çojë në probleme serioze politike e sociale që rrezikojnë mjaft bizneset e këtij vendi. Ndryshimi i vazhdueshëm i prodhimit dhe shërbimeve, ndryshimi i konkurrentëve,

<sup>5</sup> Skender Ahmeti: Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2012, f. 29, 30.

<sup>6</sup> Rustem Asllanaj: Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2010, f. 20, 21.

ndryshimet e shpejta sociale dhe novacionet teknologjike e vështirësojnë mjaft parashikimin e të ardhmes.<sup>7</sup>

### **Faktorët e jashtëm dhe të brendshëm të mjedisit biznesor**

#### **Analiza e mjedisit të jashtëm**

Mjedisi i jashtëm i biznesit është gjithmonë në ndryshim. Për t'i paraprirë konkurrencës kompania duhet që në mënyrë konstante të vlerësojë tendencat ose modelet e ndryshimit në mjedis, sikurse janë tendencat e tregut. Këtu mund të përfshihen ndryshimet në dëshirat dhe pritjet e klientit dhe mënyrave sipas të cilave konkurrentët janë duke i përmbushur këto dëshira. Përveç tendencave të tregut analiza e mjedisit vlerëson edhe tendencat ekonomike, politike dhe sociale që mund të ndikojnë në biznes.<sup>8</sup>

Analiza e mjedisit të jashtëm është procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të faktorëve të mjedisit të jashtëm që rrethon një organizatë me qëllim që të përcaktohen tendencat pozitive dhe negative që ndikojnë në performancën e organizatës. Shanset janë tendenca apo ndryshime pozitive të mjedisit të jashtëm që mund të ndihmojnë organizatën të përmirësojë performancën e saj. Kërcënimet janë tendenca apo ndryshime negative të mjedisit të jashtëm që mund të ulin performancën e organizatës. Mjedisi i jashtëm i një firme përbëhet nga tri elemente kryesore: mjedisi i largët (forcat e të cilit veprojnë pavarësisht nga vullneti i organizatës), mjedisi konkurrues (forcat e industrisë, në të cilat organizata mund të veprojë) dhe mjedisi i afërt.

**Mjedisi i largët** përfshin pesë forca kryesore: ekonomike, sociale, politiko-ligjore, teknologjike dhe ekologjike.

- Faktorët ekonomikë kanë të bëjnë me natyrën dhe drejtimin e ekonomisë ku firma zhvillon aktivitetin e saj. Përqindjet e inflacionit, përqindjet e interesit dhe pritjet e rritjes së produktit të përgjithshëm janë gjithashtu faktorë tjerë ekonomikë që duhet të mbahen parasysh nga firma në planifikimin strategjik. Stadi i ciklit ekonomik ka ndikim të drejtpërdrejtë në GDP, nivelin e të ardhurave, nivelin e investimeve dhe shitjeve.

- Faktorët socialë përfshijnë besimet, vlerat, qëndrimet, opinionet dhe mënyrën e jetesës së individëve që bëjnë pjesë në mjedisin e

<sup>7</sup> Vasilika Kume, Menaxhimi strategjik, Tiranë, 2010, f. 87.

<sup>8</sup> Suzana Panariti: Menaxhimi I Operacioneve, Tiranë, 2008, 36.

jashtëm të firmës. Faktorët socialë kushtëzohen nga gjendja kulturore, ekologjike, demografike, fetare, arsimore dhe etnike e vendit ku firma zhvillon aktivitetin e saj.

- Faktorët politikë përcaktojnë parametrat ligjorë dhe rregullues brenda të cilave firma duhet të veprojë. Ndër këta faktorë janë: vendimet për një tregti të ndershme, ligjet antitrust, programet e taksave, legjislacioni për pagën minimale, politikat dhe programet e mbrojtjes së mjedisit nga ndotja, si dhe një sërë politikash të tjera për mbrojtjen e interesave të punonjësve, konsumatorëve e publikut në përgjithësi. Këta faktorë ulin mundësitë potenciale të fitimeve të firmave. Por krahas tyre ka dhe veprime politike që janë në favor dhe në mbrojtje të interesave të firmave. Siç janë: ligjet për mbrojtjen e patentës, subvencionet shtetërore, lejimi i kërkimeve të ndryshme shkencore, etj.

- Faktorët teknologjikë - për të shmangur vjetrimin para kohe të makinerive e pajisjeve dhe për të nxitur novacionet, një firmë duhet të jetë në dijeni të ndryshimeve teknologjike që influencojnë në aktivitetin e saj. Përshtatjet teknologjike mund të krijojnë mundësi për prodhim produktesh të reja, për përmirësimin e produkteve ekzistuese, ose të teknikave të prodhimit e të marketingut.

- Faktorët ekologjikë nënkuptojnë marrëdhëniet që ekzistojnë midis njeriut e qenieve të gjalla, nga njëra anë, dhe ujit, tokës dhe ajrit, nga ana tjetër. Bizneset, duke qenë kontribuesit kryesorë të ndotjes së mjedisit, duhet të mbajnë përgjegjësi për eliminimin e mbeturinave të rrezikshme dhe pastrimin e mjedisit nga ndotja.

**Mjedisi konkurrues** - për shumë organizata ekzistojnë një numër influencash, të cilat janë më të afërta, dhe mbi të cilat organizata mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ky quhet mjedisi i industrisë ose mjedisi konkurrues. Ai përfshin faktorë të cilët ndikojnë direkt në aftësinë e organizatës për t'u pozicionuar kundrejt rivalëve të saj. Organizatat duhet të luftojnë për të përballuar konkurrencën, të njohin fuqitë dhe dobësitë e konkurrentëve. Forcat konkurruese përcaktojnë përfitueshmërinë e një industrie.

**Mjedisi i afërt** – quhet mjedisi i detyruar ose operues, përfshin faktorët që ndikojnë në suksesin e firmës, si për gjetjen e burimeve të nevojshme për prodhimin e produkteve e shërbimeve, ashtu edhe për shitjen e tyre. Ndër këta faktorë rëndësi kanë: përcaktimi i pozitës konkurruese të firmës, parashikimi i konsumatorëve të saj, reputacioni

i firmës tek furnitorët dhe kreditorët dhe aftësia e saj në tërheqjen e punonjësve të aftë.<sup>9</sup>

### **Analiza e mjedisit të brendshëm**

Analiza e mjedisit të brendshëm të organizatës ka për qëllim studimin e të gjithë faktorëve që veprojnë brenda një organizate, me qëllim përcaktimin e dobësive dhe fuqive të saj. Formulimi i një strategjie efektive bazohet në një përcaktim të qartë të misionit të kompanisë, një vlerësim të kujdesshëm të mjedisit të jashtëm, dhe një analizë të plotë të mjedisit të brendshëm të firmës. Strategjet duhet të analizojnë me kujdes informacionin e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të organizatës për të ndërmarrë vendime strategjike. Strategjet duhet të njohin fuqitë dhe dobësitë e mjedisit të brendshëm për t'ju përgjigjur në mënyrë optimale shanseve dhe kërcënimeve të mjedisit të jashtëm.

Planifikimi strategjik dhe marrja e vendimeve në nivel korporate nuk mund të jenë të suksesshëm pa një njohje të mirë të faktorëve strategjikë brenda saj. Këta faktorë strategjikë, të cilët mund të kthehen në fuqi apo në dobësi për korporatën, janë struktura, kultura dhe burimet.

**Struktura e organizatës** përkufizohet me termat e komunikimit, autoritetit dhe marrëdhënieve të ndërsjella brenda organizatës. Ajo ka të bëjë me koordinimin e roleve dhe marrëdhënieve të punonjësve brenda firmës. Në qoftë se struktura përputhet me ndryshimet e propozuara në strategji, kemi të bëjmë me një fuqi, dhe në të kundërtën kemi të bëjmë me një dobësi të firmës.

**Kultura e organizatës** është një koleksion besimesh, shpresash dhe vlerash të mishëruara në anëtarët e organizatës dhe që transmetohen brez pas brezi. Kjo krijon normat që përcaktojnë sjelljen e punonjësve të firmës, që nga drejtimi i lartë e deri tek punonjësi më i thjeshtë. Kultura e organizatës në përgjithësi reflekton misionin e saj. Kultura përfshin orientimin kryesor të kompanisë. Disa kompani orientohen drejt tregut, kompani të tjera mund të jenë të orientuara drejt produktit (p.sh. firma të çelikut, naftës, spitalet, bankat etj.), disa drejt teknologjisë etj.

**Burimet e organizatës** konsiderohen burimet financiare, fizike, njerëzore si dhe aftësitë teknologjike dhe organizative të saj. Burimet funksionale përfshijnë jo vetëm njerëzit që punojnë në këto departamente por edhe konceptet analitike dhe teknikat procedurale që

---

<sup>9</sup> Vasilika Kume, Menaxhimi Strategjik, Tiranë, 2010, f. 89 - 92, 103, 121, 128.

përdoren atje. Studimi i burimeve mund të jetë një pikë nisje e dobishme për njohjen e kapacitetit strategjik. Ai vlerëson fuqinë e bazës së burimeve – sasinë dhe natyrën e burimeve.<sup>10</sup>

### **Informatat financiare për krijimin e përparësive konkurruese**

Aktivitetet e ndërmarrja nga biznesi janë drejtpërdrejt të lidhura me arritjen e përparësisë konkurruese. Një biznes që dëshiron t'i tejkalojë konkurrentët e tij përmes dallimit të tij me cilësi më të lartë do të duhej t'i performonte aktivitetet e zinxhirit të vlerave më mirë se sa konkurrentët e tij. Në të kundërtën, strategjia e bazuar në kërkimin e leadershipit të kostos do të kërkojë zvogëlimin e shpenzimeve të ndërlidhura me aktivitetet e zinxhirit të vlerave, apo zvogëlim në shumën e përgjithshme të burimeve. Porter-i identifikoi 10 shtytës të kostos të ndërlidhur me aktivitetin e zinxhirit të vlerave: Ekonomia e shkallës; Njësia mësimore; Shfrytëzimi i kapaciteteve; Lidhjet ndërmjet aktiviteteve; Marrëdhëniet e brendshme ndërmjet njësive të biznesit; Shkalla e integritimit vertikal; Koha e hyrjes në treg; Politika e firmës për koston; Lokacioni gjeografik; Faktorët institucional (rregulloret, aktiviteti i sindikatave, etj.)<sup>11</sup>

Avantazhi konkurrues përcakton aftësinë e firmës për të arritur epërsi në treg kundrejt konkurrentëve të saj. Në këndvështrimin afatgjatë, avantazhi i qëndrueshëm konkurrues siguron performancën mbi nivelin mesatar dhe është thelbësor për mbijetesën e biznesit. Krijimi i avantazhit konkurrues kërkon njohjen e dy gjërave kryesore: njohjen e nevojave dhe dëshirave të klientit, si dhe aftësitë e operacioneve për të mbështetur prioritetet konkurruese të dëshiruara.<sup>12</sup> Të kesh një avantazh konkurrues do të thotë të bësh diçka më mirë se të tjerët ose të bësh një gjë që të tjerët nuk e bëjnë dhe për rrjedhojë të kesh rezultate më të mira se të tjerët. Menaxhimi i avantazhit konkurrues i çon organizatat në sukses apo dështim. Disa nga treguesit që e përcaktojnë pozitën konkurruese janë: pjesa e tregut; gjerësia e linjës së produktit; çmimi konkurrues; eksperiencia; kostoja e lëndëve të para; pozita financiare; vendosja dhe jetëgjatësia e makinerive e pajisjeve; cilësia relative e produkteve; avantazhet ose niveli i kërkim zhvillimit; cilësia e personelit;

<sup>10</sup> Vasilika Kume: Menaxhimi Strategjik, Tiranë, 2010, f. 151, 152.

<sup>11</sup> [http://www.zarateconsult.de/kosvet3/alb/m4/KEET\\_M4\\_LU5\\_L5/lidhja\\_e\\_analizes\\_s\\_zinxhirit\\_t\\_vlerave\\_me\\_prparsin\\_konkuruese.html](http://www.zarateconsult.de/kosvet3/alb/m4/KEET_M4_LU5_L5/lidhja_e_analizes_s_zinxhirit_t_vlerave_me_prparsin_konkuruese.html)

<sup>12</sup> Suzana Panariti: Menaxhimi I Operacioneve, Tiranë, 2008, f. 40.



efektiviteti i reklamës dhe promocionit. Për të përcaktuar pozitën e saj konkurruese firma duhet të zgjedhë në radhë të parë treguesit, pastaj të shprehë në përqindje rëndësinë e tyre dhe të bëjë renditjen sipas rëndësisë. Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon firmën të njohë deri diku pozitën e saj konkurruese dhe të bëjë të mundur zbatimin e strategjive të saj.<sup>13</sup>

### **Organizimi i kontabilitetit dhe sistemet e tij**

Për të siguruar grumbullimin dhe përpunimin e informacionit ekonomik mbi njësinë ekonomike për t'iu komunikuar përdoruesve, kontabiliteti ka nevojë të ketë të përcaktuara procedurat e këtij procesi, të ketë gjithashtu edhe mjetet e përcaktuara për realizimin e këtij procesi, si edhe rregulla të qarta të realizimit, të grumbullimit e të përpunimit të informacionit kontabël. Në përpjekje për të siguruar një përpunim të shpejtë dhe të saktë të informacionit financiar, kontabiliteti mund të organizohet në mënyra të ndryshme. Objektivi i kontabilitetit është i trefishtë:

- a) Të japë një informacion të mirë e të saktë, me qëllim që të mbrojë më mirë interesat e anëtarëve të njësisë ekonomike dhe të të tretëve.
- b) Të administrojë pasurinë e njësisë ekonomike, me qëllim që të zbulojë ata që mundohen ta dëmtojnë, shpërdorjnë apo ta vjedhin atë.
- c) Të caktojë rregulla minimale të përbashkëta, me qëllim që të bëjë të krahasueshme kontabilitetet e vendeve të ndryshme.

Kontabiliteti duhet të organizohet në mënyrë që të lejojë:

- Mbledhjen e plotë, regjistrimin kronologjik dhe ruajtjen e të dhënave bazë;
- Disponibilitetin e informacioneve elementare dhe ndërtimin në kohën e duhur të bilancit dhe pasqyrave financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të lëvizjes së kapitalit, të lëvizjes së mjeteve monetare etj.;
- Kontrollin e saktësisë së të dhënave dhe të procedurave të trajtimit.<sup>14</sup>

### **Sistemi i kontabilitetit**

Sistemi kontabël përbëhet nga politikat, procedurat, dokumentet dhe formularë që përdoren për të regjistruar e raportuar aktivitetin ekonomik të njësisë. Struktura organizative e sistemit të kontabilitetit, është e varur nga madhësia e ndërmarrjes, por njëkohësisht është çështje

<sup>13</sup> Vasilika Kume: Menaxhimi Strategjik, Tiranë, 2010, f. 121, 169.

<sup>14</sup> Agim Binaj & Flutura Kalemi: Kontabiliteti, Tiranë, 2006, f. 33, 34.

preferenciale e menaxhmentit të ndërmarrjes. Operacionet kryesore, në praktikën e sistemit të kontabilitetit, janë:

- Udhëheqja e librit kryesor,
- Të kërkesave të arkëtueshme,
- Llogarive të pagueshme,
- Kontabilitetit të rezervave,
- Kontabilitetit të pasurisë fikse etj.<sup>15</sup>

Detyra e një sistemi kontabiliteti është të përpunojë të dhënat ekonomike që rrjedhin nga transaksionet e kryera në njësinë ekonomike. Ai mund të konsiderohet si sistem përpunimi të dhënash, e kryer kjo me dorë apo me ndihmën e kompjuterëve. Gjithashtu, kontabiliteti është një pjesë e rëndësishme e kontroleve të brendshme, duke siguruar informacion në lidhje me mënyrën e administrimit të pasurisë nga ana e drejtuesve të niveleve të ndryshme të njësisë.<sup>16</sup> Në këto aspekte tepër materiale, njësia ekonomike duhet të adaptojë një numër procedurash të trajtimit të informacionit. Sistemi kontabël i përgjigjet këtij objekti meqenëse ai përcakton metodat dhe mjetet e vëna në zbatim nga njësia për të organizuar kontabilitetin e saj. Llojet kryesore të organizimit të kontabilitetit janë:

**a) Sistemi klasik i kontabilitetit (sistemi italian)**

Në këtë sistem tradicional, veprimet regjistrohen në dy kohë. Në fillim, pjesa justifikuese regjistrohet në ditar, dhe në të dytën, artikulli i ditarit hidhet në llogaritë e Librit të Madh. Kjo procedurë kërkon një regjistrim të dyfishtë, gjë që, sigurisht, është një burim gabimesh dhe humbje kohe.

**b) Sistemi i informatizuar (sistemi i ditarëve special “analitik”)**

Ky sistem përmirëson sistemin klasik duke krijuar mundësinë e regjistrimeve të veprimeve homogjene në disa ditarë dhe pastaj mbartjen e totaleve të ditarëve analitik në ditarin e përgjithshëm dhe mbartja pastaj në llogaritë e librit të madh. Shumica e njësive ekonomike tashmë janë të pajisura me sisteme të informatizuara, që bashkojnë shpejtësinë, besueshmërinë dhe shumë mundësi të trajtimit dhe përdorimit të informacionit.<sup>17</sup>

<sup>15</sup> Rustem Asllanaj: Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2010, f. 24.

<sup>16</sup> Sotiraq M. Dhamo: Kontabiliteti i Avancuar, Tiranë, 2005, f. 3.

<sup>17</sup> Agim Binaj & Flutura Kalemi: Kontabiliteti, Tiranë, 2006, f. 45.

Sistemi informativ i kontabilitetit është përgjegjës për:

1. Identifikimin e resurseve në ndërmarrje
2. Përcjelljen e transformimit të resurseve të shitura blerësve si mallra dhe shërbime ose përfitimet nga marrjet
3. Determinimin e kostos së resurseve të përdorura nga ndërmarrja
4. Raportimin e informacioneve për këto aktivitete për përdorim intern dhe ekstern.<sup>18</sup>

### c) Sistemi amerikan i kontabilitetit

Ky sistem realizon bashkimin e hapave të regjistrimit në ditar dhe të mbartjes në llogari në një hap të vetëm. Është i thjeshtë dhe mjaft praktik, por vetëm për ato njësi të cilat kanë një numër të kufizuar veprimesh, dhe si rrjedhim edhe llogarish.<sup>19</sup>

Cilido qoftë sistemi kontabël i adaptuar, është e detyrueshme të ndërtohet një dokument që përshkruan procedurat dhe metodat kontabël, me qëllim që të mund të kuptohet organizimi i sistemit informatik i përdorur. Në këtë dokument vend të rëndësishëm duhet të zënë: lista e llogarive, dokumentet kontabël të shkruara, përshkrimi i materialeve dhe procedurave të zbatuara në informatizimin e kontabilitetit etj.<sup>20</sup>

### Zhvillimi historik i kontabilitetit në Kosovë

Në periudhën e pasluftës, edhe në Kosovë, ka lëvizje pozitive në drejtim të zhvillimit të Kontabilitetit. Ndërtimit të sistemit të kontabilitetit mbi bazat e SNK-së, nuk mund t'i shmanget as Kosova si pjesë e Evropës dhe e këmbimit ndërkombëtar. Autoritet Qendror i Kosovës, për nxjerrjen e SKK-së, është Bordi i Raportimit Financiar. Deri më tani, nga ky bord, janë nxjerrë 19 Standarde Kosovare të Kontabilitetit (SKK), të cilat janë në harmoni me SNK-në. Përderisa në shumicën e shteteve të botës roli i informatave të kontabilitetit, në vlerësimin e përgjithshëm të pozitës financiare të ndërmarrjes, është i madh, kjo nuk mund të thuhet se vlen në rrethanat e tanishme edhe për kontabilitetin e ndërmarrjeve në shtetin e Kosovës.<sup>21</sup> Standardet Kosovare të Kontabilitetit janë miratuar nga Autoriteti Qendror Fiskal në vitin 2001 dhe janë marrë nën përgjegjësi nga Bordi Kosovar mbi Standardet e Raportimit

<sup>18</sup> Rustem Asllanaj: Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2010, f. 24.

<sup>19</sup> Sotiraq M. Dhamo: Kontabiliteti i Avancuar, Tiranë, 2005, f. 17.

<sup>20</sup> Agim Binaj & Flutura Kalemi: Kontabiliteti, Tiranë, 2006, f. 45.

<sup>21</sup> Rustem Asllanaj: Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2010, f. 35.

Financiar. Këto standarde shtrojnë kërkesa të mbajtjes së evidencës kontabël dhe përgatitjes së raporteve financiare të cilat janë ndryshe nga kërkesat e paraluftës. Trajnimi për kërkesat e reja të raportimit financiar u fillua dhe ende është duke u vazhduar nga Kosova Business Support (“KBS”), një organizatë e financuar nga USAID. KBS po ashtu ka themeluar dhe bënë mbikëqyrjen e Shoqatës Kosovare të Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), shoqatë e cila anëtarëson të certifikuarit nga ky trajnim. Ky trajnim ka ndikuar deri diku që kërkesat e reja të njihen dhe zbatohen nga komuniteti i biznesit.<sup>22</sup> Zhvillimi i kontabilitetit në Kosovë është i ndërlidhur me shumë zhvillime dhe faktor. Është posaçërisht me interes analizimi i marrëdhënieve në mes të zhvillimit të kontabilitetit dhe revizionit, zhvillimit në përgjithësi të Kosovës dhe zhvillimit të institucioneve të Kosovës. Përfundimi i luftës në Kosovë dhe pavarësia e Kosovës mund të shërbejnë si pikënisje për matje kohore për këto zhvillime. Meqë kontabiliteti kryhet në bazë të zbatimit të standardeve të caktuara, është shumë me rëndësi që të dihet niveli i zbatimit të këtyre standardeve në praktikë.

Që nga fundi i luftës, njohuritë dhe përvoja në standardet e kontabilitetit janë rritur përmbytësisht tek një numër i madh i kontabilistëve. Kjo paraqet themel të shëndosh për zhvillim të mëtutjeshëm. Pas luftës, ne kemi fillimin e zbatimit të standardeve profesionale në kontabilitet dhe revizion. Përveç zbatimit të standardeve të reja, zhvillimet e reja biznesore kanë krijuar praktika dhe klasa të transaksioneve që nuk janë njohur më parë. Në përgjithësi, mund të konsiderohet që zbatimi i standardeve të reja mund të jetë ndoshta shumë i lartë për një zbatim në përdorim të mjaftueshëm. Të gjitha këto kushte kanë shkaktuar vështirësi në zbatim vërtet të plotë të kërkesave të standardeve profesionale.

Dikush që do të zbatonte të gjitha ose shumicën e të gjitha standardeve profesionale në Kosovë do të kishte vështirësi të mëdha të mbijetojë, për disa arsye:

a) Zbatimi i standardeve profesionale do të merr më shumë kohë për të kryer angazhimin gjë që do të bënte atë më të shtrenjtë. Kërkesa e tregut për punë është e mjaftueshme të përmbush kërkesat formale ligjore. Meqë nuk ka pasoja ligjore ose profesionale, të tjerët do të kryenin punën e njëjtë pa zbatimin e standardeve. Sa më pak që standardet zbatohen, aq më pak punë është e nevojshme, tarifë më ultë do të kërkohet.

<sup>22</sup> <http://www.luani.net/publikimet-artikujt/items/kerkesat-e-rregullores-mbi-standardet-e-raportimit-financiar.html>

b) Gjithashtu, dikush që zbaton standardet profesionale do të paraqesë pamje të drejtë dhe reale. Kur kërkesa e tregut është për mos paraqitje të pamjes reale dhe të drejtë, sigurisht dikush që nuk i zbaton standardet do të angazhohet.<sup>23</sup>

### **Cilësia e raportimit financiar në Kosovë**

#### **Raportimi financiar**

Kontabiliteti mat dhe raporton rezultatet e transformimit të burimeve të një kompanie në mallra dhe shërbime për t'iu shitur konsumatorëve. Raportimi financiar është një mënyrë e regjistrimit, analizimit dhe përmbledhjes së të dhënave financiare.<sup>24</sup> Objektivat e raportimit financiar japin një qëllim të përgjithshëm për raportimin financiar. Qëllimi i raporteve financiare është dhënia e informacionit të dobishëm për investitorët, kreditorët dhe përdoruesit e tjerë të tanishëm dhe të mundshëm. Raportet financiare duhet t'i ndihmojnë këta vendimmarrës për të pasur hyrje në shumat, kohët dhe perspektivat e pasigurta të rrjedhjes së parave. Raportet financiare duhet të japin gjithashtu informacion mbi burimet, pretendimet për burimet dhe ndryshimet në burime për organizatat e biznesit. Raportimi financiar kryhet prej të gjitha bizneseve, pavarësisht prej madhësisë ose strukturës së tyre. Qëllimi i matjes dhe i regjistrimit të aktiviteteve të biznesit është që të ofrojë informacione të dobishme për ata të cilët kanë nevojë të marrin vendime. Kontabiliteti raporton informacione për vendimmarrësit në formën e raporteve financiare. Raportet financiare janë raporte që përmbledhin rezultatet e veprimeve kontabël të një kompanie për një periudhë fiskale. Për të përgatitur raportet financiare, një kompani ka nevojë të identifikojë bilancet e llogarive të saj në fund të periudhës fiskale që po raportohet. Kontabiliteti i raporton veprimet e biznesit në formën e raporteve:

a) Një raport të ardhurash raporton të hyrat, shpenzimet dhe të ardhurën neto nga një periudhë fiskale si një masë e rezultatit të veprimeve.

b) Një bilanc raporton asetet e kontrolluara nga një kompani dhe pretendimet mbi këto asete nga kreditorët dhe pronarët në një kohë të caktuar, zakonisht në fund të një periudhe fiskale.

c) Një raport i rrjedhjes së parave raporton paratë që janë marrë ose janë paguar nga kompania gjatë një periudhe fiskale.

<sup>23</sup> [http://www.luani.net/publikimetartikujt/items/kontributi\\_i\\_kontabilitetit\\_dhe\\_revizionit\\_n%c3%8b\\_zhvilliminekonomik\\_t%c3%8b\\_kosov%c3%8bs.html](http://www.luani.net/publikimetartikujt/items/kontributi_i_kontabilitetit_dhe_revizionit_n%c3%8b_zhvilliminekonomik_t%c3%8b_kosov%c3%8bs.html)

<sup>24</sup> SHKÇAK: P1 , Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2008, f. 12, 18.

Elementët kryesore të raporteve financiare të një biznesi janë bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave. Raportet financiare krahasojnë një raport financiar me një tjetër.<sup>25</sup>

### **Raportimi financiar në Kosovë**

Profesioni i raportimit financiar në Kosovë ishte zhvilluar gjatë kohës së socializmit si pjesë e zhvillimeve profesionale në Jugosllavi. Profesioni i raportimit financiar në Jugosllavi ka përfshirë dispozita të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të standardeve ndërkombëtare të revizionit. Anulimet Kushtetuese të Kosovës në vitin 1989 shkatërruan ekonominë e Kosovës, duke lënë në veprim vetëm disa kompani tregtare. Për shkak të kësaj situate, profesioni i raportimit financiar u shkatërrua me shkallë të njëjtë. Kjo periudhë zgjati deri në përfundim të luftës.

Profesioni i raportimit financiar në Kosovë pas luftës filloj një epokë të re të zhvillimit duke sjellë bazat e tij në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pas luftës, profesioni i raportimit financiar filloj të zhvillohet nga supozimi që njohurit dhe përvojat e mëparshme nuk janë të vlefshme për zhvillimet e ardhme. Planprogrami i parë për trajnimin e kontabilistëve dhe revizorëve ishte më tepër një njohuri fillestare. Ky planprogram disa vjet më vonë u ngritë për kah niveli për të pasur disa standarde të pranueshme profesionale. Planprogrami i trajnimeve të kontabilistëve dhe revizorëve dhe korniza ligjore lidhur me profesionin është krijuar në përputhje me vijat e standardeve ndërkombëtare. Ky profesion është shërbim që u ofrohet bizneseve dhe palëve tjera të interesit në shoqëri dhe se është i ndikuar nga kërkesa në treg për këto shërbime. Shoqata e re profesionale u themelua si një shoqatë që të shërbej si strehë për të gjithë anëtarët e shoqatës. Gjithashtu trupa e re profesionale, Bordi Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar (BKSRF), u themelua si vendosës i standardeve dhe mbikëqyrës i profesionit të raportimit financiar. Profesioni i raportimit financiar bazohet në fakte dhe zhvillimi i profesionit bëhet përmes konfrontimit të fakteve. Vendimet merren duke u bazuar në fakte dhe jo në mendimin e shumicës. Që nga përfundimi i luftës, profesioni i raportimit financiar në Kosovë është zhvilluar vetëm përmes prezantimit të ligjeve, rregullave, rregulloreve, planprogrameve dhe të ngjashme. Pas luftës, ne kemi fillimin e zbatimit të standardeve profesionale në kontabilitet dhe

<sup>25</sup> Robert W. Ingram, Thomas Albright, and Bruce A. Baldwin: Kontabiliteti Financiar, Prishtinë, 2004, f. 64, 74, 256.

revizion. Përveç zbatimit të standardeve të reja, zhvillimet e reja biznese kanë krijuar praktika dhe klasa të transaksioneve që nuk janë njohur më parë.<sup>26</sup>

### **Conclusion**

The role and function of the accountant and the accounting department is to produce information that has the necessary qualities for the needs of parties of social interest. To make it possible that the accountant to produce the qualitative information and to fill out the needs of parties of social interest, first is necessary to understand the needs of these parties. These needs are certain by the environment and the conditions under which society develops. Strengthening the process of defining the standards without strengthening similar to the monitoring and enforcement mechanism will fail and will not reach to treat the mismatch with accounting standards. Critical factors of success for implementation include leadership from the highest levels of government, capitalization for the desire to change and balancing stimulation and convictions for compliance with financial reporting requirements.

The profession of financial report is just a professional service that is offered in society. Certainly any society will need and look for good professional services. The high quality of professional services of financial report would be high contribution for the investments in Kosovo, for the business community and the society as a whole. The profession of financial reporting that it may complete role and his function and to ensure its sustainable development, it needs for further development. Development does not come by itself, for more it should have built its own mechanisms within the profession that they can secure its development. The mechanisms will make it possible the profession to be controlled by professionals and ensure more professionalism. The profession that holds a high level of implementation of professional standards will be able to offer businesses and other parties with a good quality of professional services. The high quality of professional services will be a valuable source of benefit for business in Kosovo, local and international investors and generally economic development and well-being in Kosovo.

---

<sup>26</sup> [http://www.luani.net/publikimetartikujt/items/kontributi\\_i\\_kontabilitetit\\_dhe\\_revizionit\\_n%c3%8b\\_zhvilliminekonomik\\_t%c3%8b\\_kosov%c3%8bs.html](http://www.luani.net/publikimetartikujt/items/kontributi_i_kontabilitetit_dhe_revizionit_n%c3%8b_zhvilliminekonomik_t%c3%8b_kosov%c3%8bs.html)

**Referenca**

- Asllanaj, Rrustem, “Kontabiliteti Financiar”, Prishtinë, 2010
- Ahmeti, Skender, “Kontabiliteti Financiar”, Prishtinë, 2012
- Dhamo, Sotiraq, “Kontabiliteti i Avancuar”, Tiranë, 2005
- Binaj Agim, Kalemi Flutura, “Kontabiliteti”, Tiranë, 2006
- SCAAK, “Kontabiliteti Financiar P1”, Prishtinë, 2008
- Kume, Vasilika, “Menaxhimi Strategjik”, Tiranë, 2010
- Panariti, Suzana, “Menaxhimi i Operacioneve”, Tiranë, 2008
- Ingram Robert, Albright Thomas, Baldwin Bruce, “Financial Accounting (Information for decision)”, Thomson South – Western, 2003
- “Kërkesat e rregullores mbi Standardet e Raportimit Financiar”, <http://www.luani.net/publikimet-artikujt/items/kerkesat-e-rregullores-mbi-standardet-e-raportimit-financiar.html>
- “Kontributi i Kontabilitetit dhe Revizionit në Zhvillimin Ekonomik të Kosovës”, [http://www.luani.net/publikimetartikujt/items/kontributi\\_i\\_kontabilitetit\\_dhe\\_revizionit\\_n%c3%8b\\_zhvilliminekonomik\\_t\\_%c3%8b\\_kosov%c3%8bs.html](http://www.luani.net/publikimetartikujt/items/kontributi_i_kontabilitetit_dhe_revizionit_n%c3%8b_zhvilliminekonomik_t_%c3%8b_kosov%c3%8bs.html)
- “Lidhja e analizës së zinxhirit të vlerave me përparësinë konkurruese”, [http://www.zarateconsult.de/kosvet3/alb/m4/KEET\\_M4\\_LU5\\_L5/lidhja\\_e\\_analizs\\_s\\_zinxhirit\\_t\\_vlerave\\_me\\_prparsin\\_konkuruese.html](http://www.zarateconsult.de/kosvet3/alb/m4/KEET_M4_LU5_L5/lidhja_e_analizs_s_zinxhirit_t_vlerave_me_prparsin_konkuruese.html)